



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.86

11 korrik

2007

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9762 datë 25.6.2007	Për disa ndryshime në ligjin nr.8782, datë 3.5.2001 “Për shoqëritë e kursim-kreditit” 2515
Dekret nr.5388 datë 5.7.2007	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare 2516
Dekret nr.5389 datë 6.7.2007	Për lirim ambasadori 2517
Dekret nr.5390 datë 6.7.2007	Për lirim ambasadori 2517
Dekret nr.5391 datë 6.7.2007	Për emërim ambasadori 2518

LIGJ
Nr.9762, datë 25.6.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8782, DATË 3.5.2001 “PËR SHOQËRITË E KURSİM-KREDITIT”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8782, datë 3.5.2001 “Për shoqëritë e kursim-kreditit”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 8 fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Emri i shoqërisë së kursim-kreditit në letrat zyrtare, publike dhe në dokumente të tjera të shoqërisë paraprihet nga fjalët “shoqëri kursim-krediti”, pas të cilave shkruhet emri i saj dhe numri i regjistrimit, të marrë nga organi i ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin e subjekteve.”.

Neni 2

Në nenin 37 fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Kryetari i bordit drejtues ka të drejtën e regjistrimit të shoqërisë së kursim-kreditit në organin e ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin e subjekteve.”.

Neni 3

Në nenin 38 paragrafi i parë shfuqizohet.

Neni 4

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 39

Shoqëritë e kursim-kreditit regjistrohen në organin e ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin e subjekteve. Procedurat, afatet e regjistrimit dhe procedura ankimore kundër vendimit, që refuzon regjistrimin e shoqërisë së kursim-kreditit, rregullohen sipas procedurave të parashikuara në ligjin për organin e regjistrimit të subjekteve.”.

Neni 5

Në nenin 40 paragrafi i parë, fjalët “gjykatën e rrethit gjyqësor të Tiranës” zëvendësohen me fjalët “organin e ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin e subjekteve”.

Neni 6

Në nenin 45 paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Pasi regjistrohen në organin e ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin e subjekteve, shoqëritë e kursim-kreditit ose unioni duhet të marrin licencë nga agjencia rregullatore, për të vepruar si një shoqëri kursim-krediti ose si një union, para se të fillojnë operacionet e veprimtarisë si një

shoqëri kursim-krediti ose si një union.”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi më 1 shtator 2007.

**Shpallur me dekretin nr.5386, datë 2.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

**DEKRET
Nr.5388, datë 5.7.2007**

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|-----------------------------------|---|
| 1. Genci Ylli Bega | 18. Irena Bashkim Bejleri |
| 2. Rezarta Rexhep Stagge (Farozi) | 19. Hibe Pijazit Hysa |
| 3. Maringlen Gëzim Sheqeri | 20. Zamir Mustafa Hoxha |
| 4. Afërdita Selim Hoxha (Selmani) | 21. Albert Rexhep Lila |
| 5. Enisa Zejdë Hoxha | 22. Shkëlqeza Ramadan Lietzau (Hajredini) |
| 6. Dorisa Zejdë Hoxha | 23. Shpresa Jemin Kokonozi |
| 7. Shkëlqim Zejdë Hoxha | 24. Julinda Ferdinand Mëhilli |
| 8. Kolec Tonin Stanaj | 25. Fatjon Skënder Ademi |
| 9. Ermira Dhimitri Strobel (Mano) | 26. Vjollca Tajar Ademi (Kazazi) |
| 10. Ali Shaqir Shaqja | 27. Emanuela Xhevdet Hainz (Kazazi) |
| 11. Nada Haki Shehi | 28. Panajot Minella Suxho |
| 12. Abaz Mehmet Qarri | 29. Afërdita Islam Sula (Rezi) |
| 13. Mikel Jani Petro | 30. Rüdiger Arben Sula |
| 14. Ndoc Vlash Ndoka | 31. Sokol Zija Lapaj-Enzenhofer (Lapaj) |
| 15. Manjola Dalip Raich (Cako) | 32. Gentjana Vasil Oberle (Shabani) |
| 16. Naim Baki Gjoka | 33. Roland Kostandin Floqi |
| 17. Shkëlzen Kastriot Përmeti | 34. Lokol Bajram Xhaja |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu**

**DEKRET
Nr.5389, datë 6.7.2007**

PËR LIRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92 pika “dh” të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Kastriot Robo lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe, rezident, si dhe e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Irlandë, jorezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5390, datë 6.7.2007

PËR LIRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92 pika “dh” të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Zef Mazi lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë pranë Misionit të OSBE-së dhe Organizatave Ndërkombëtare në Vjenë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5391, datë 6.7.2007

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92 pika “dh” dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Zef Mazi emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Irlandë, jorezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 10.7.2007
Doli nga shtypi më 11.7.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 8 lekë